



MINISTRIA
E SHËNDETËSISË
Republika e Kosovës



Vaksinohuni



PARANDALO GRIPIN DUKE U VAKSINUAR!

**Vaksinohuni, mbroni vetveten,
familjen dhe njerëzit rreth jush!**

Vaksinimi është metoda më e mirë për parandalimin e gripit!

ÇKA ËSHTË GRIPI SEZONAL?

Gripi sezonal është sëmundje shumë ngjitëse që shkaktohet nga virusi i gripit.

Gripi qarkullon në komunitet gjatë sezonës së gripit. Zakonisht paraqitet në fillim të muajit tetor dhe zgjat deri në fund të muajit prill.

SI BARTET?

Gripi bartet nga njeriu tek njeriu me spërkla gjatë testimave, kollitjes apo gjatë bisedimit si dhe qëndrimin për kohë të gjatë në ambiente të mbyllura.

CILAT JANË SIMPTOMAT DHE SHENJAT MË TË SHPESHTA?

- Temperaturë e lartë
- Kollë
- Dhimbje fyti
- Dhimbje muskujsh
- Lodhje
- Dhimbje koke
- Rrjedhje e hundëve
- Dhimbje barku
- Të përziera
- Barkqitje
- Të vjella

KUSH DUHET TË VAKSINOHET?

Vaksina mund të aplikohet te çdo person që nga moshë mbi 6 muajsh, por në veçanti rekomandohet vaksinimi i këtyre grupeve të rrezikut:

- Punëtorët shëndetësorë (kanë përgjegjësi për të mbrojtur edhe pacientët, kolegët, familjarët)
- Gratë shtatzëna (pavarësisht kohës së shtatzënësisë vaksinimi ndihmon në mbrojtjen e gruas dhe fetusit, ndërsa antitrukat e krijuar në trupin e nënës kalojnë tek foshnja dhe e mbrojnë atë në muajt e parë të jetës)
- Të gjithë personat mbi moshën 65 vjeçare
- Personat me sëmundje kronike (sëmundje kardiovaskulare, sëmundje kronike të mushkërive, veshkave, mëlçisë, diabet, personat me tumore/kancere dhe sëmundje tjera shoqëruese)
- Personat me mbipeshë dhe obezë

A MUND TË SHKAKTOJË GRIPIN SËMUNDJE SERIOZE?

PO, gripin mund të shkaktojë sëmundje serioze dhe komplikime të cilat kërcënojnë jetën. Gripin gjithashtu mund të përkeqësojë gjendjet e tjera kronike. Disa persona janë më të rrezikuar nga këto komplikime serioze siç janë personat mbi moshën 65 vjeçare, shtatzënat, si dhe personat që kanë sëmundje tjera shoqëruese si diabeti apo sëmundjet kronike të mushkërive.

ÇKA ËSHTË VAKSINA E GRIPIT?

Vaksina është produkt i cili ndihmon sistemin imunitar (sistemin mbrojtës) të organizimit ta luftojë infeksionin.

A ËSHTË E SIGURTË VAKSINA E GRIPIT?

Vaksina e gripit është e sigurtë. Çdo vit, vakcina e gripit sezonal aplikohet nga miliona njerëz në mbarë botën. Bazuar në të dhëna shkencore vakcina e gripit zvogëlon rrezikun nga sëmundja dhe ulë vizitat te mjeku për 40% deri në 60%. Parandalon rreth 7.5 milionë sëmundje të gripit, 3.7 milionë vizita mjekësore, 105,000 shtrirje në spital dhe 6,000 vdekje të lidhura me gripin në mbarë botën.

CILAT JANË EFEKTET ANËSORE TË VAKSINËS SË GRIPIT?

Efektet më të shpeshta anësore janë të lehta. Pas marrjes së vaksinës mund të paraqitet skuqje dhe ënjtje në vendin e

injektimit. Ndonjëherë mund të paraqitet edhe kokë dhimbja, dhimbja e muskujve dhe lodhja. Këto efekte anësore mund të zgjasin disa ditë. Reaksionet serioze janë shumë të rralla.

A MUND TA MARR GRIPIN NGA VAKSINA E GRIPIT?

JO. Vaksina e gripit nuk mund të shkaktojë gripin.

A MBRON VAKSINA E GRIPIT KUNDËR COVID-19?

JO. Vaksina e gripit nuk mbron kundër COVID-19. Është me rëndësi të merret vakcina e gripit dhe e COVID-19 për arsye se viruset që i shkaktojnë këto dy sëmundje janë të ndryshme. Gripin dhe COVID-19 që të dyja mund të shkaktojnë sëmundje serioze. Është e vështirë të dallohen simptomat nga gripin dhe COVID-19. Edhe nëse keni marrë vaksinën kundër COVID-19 duhet të merrni vaksinën e gripit. Këto dy vakcina mund të merren në të njëjtën kohë.

SA KUSHTON VAKSINA E GRIPIT?

Vaksina e gripit ofrohet FALAS!

KU MUND TA MARR VAKSINËN E GRIPIT?

Ju mund të vaksinoheni në qendrën më të afërt të mjekësisë familjare.

